



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 61-23337/ 15
Kaçanik, 31. 07. 2015

R R E G U L L O R E

**PËR TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E NXËNËSVE TË
SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

Korrik, 2015

Në bazë të nenit 40.2 (a) të Ligjit 03/L-040 - Për Vetëqeverisje Lokale, Neni 5.1 (i) të Ligjit Nr. 03/L-068-për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, të Neni 22 të Ligjit Nr.04/L-032 - për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 02/L-42 –për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Neni 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2014, Kuvendi i Komunës i Kaçanikut, në Mbledhjen e mbajtur me 31 korrik, 2015, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Kaçanikut, shkeljet e detyrave dhe rregullave të nxënësve, masat edukative-disiplinore, procedurat për vërtetimin e përgjegjësisë së nxënësve, zhvillimi i procedurës disiplinore, e drejta për ankesë, përgjegjësia materiale për dëmin e shkaktuar në hapësirat shkollore, si dhe dispozitat e tjera.

Neni 2

Nxënësit janë pjesëmarrës në punën edukative-arsimore së bashku me mësuesit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe personelin e shkollës dhe janë përgjegjës për rezultatet e punës edukative-arsimore.

Neni 3

Shkolla është e obliguar në fillim të vitit shkollor t'i njoftojnë nxënësit me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara me këtë rregullore, por për zbatimin e rregullores kohë pas kohe nxënësit të njoftohen edhe përmes kujdestarëve të klasave.

Neni 4

Kujdestari i klasës, ka për obligim në fillim të vitit shkollor t'i njoftojë nxënësit me Rregulloren e shkollës, posaçërisht gjatë orëve të kujdestarisë.

II. TË DREJTAT E NXËNËSVE

Neni 5

Nxënësi ka të drejtë:

1. Të shkollohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Të shfaqë lirisht mendimin dhe kërkesat e tij me gojë e me shkrim dhe publikisht për preokupimet dhe problemet që e shqetësojnë atë, klasën e tij ose shkollën në tërësi.
3. Të kërkojë mbrojtje nga dhuna fizike e psikike dhe t'i respektohet dinjiteti në shkollë.
4. Të njohë dhe të respektojë konventat e të drejtave të fëmijëve dhe të kërkojë respektimin e tyre nga të tjerët.
5. Të marrë pjesë në mbledhjet e ndryshme të klasës dhe të shkollës.
6. Të ankohet në drejtorinë e shkollës ose në organet më të larta të arsimit, kur gjykon se i është bërë e padrejtë.
7. Të marrë pjesë në veprimtaritë kulturore, artistike, sportive që zhvillon klasa ose shkolla, të kërkojë dhe të marrë dokumentin përkatës kur mbaron klasën dhe shkollën ose kur kalon në një shkollë tjetër.
8. Të ndjekë rregullisht mësimin dhe format e tjera të organizuara të punës arsimore - edukative, të përcaktuara me programin vjetor të punës së shkollës.
9. Të shfrytëzojë mjetet mësimore të punës dhe mjetet e tjera të institucionit edukativ - arsimor me të cilat zhvillohet programi i punës edukative - arsimore.
10. Të ketë siguri fizike dhe shëndetësore, veçanërisht gjatë praktikës profesionale në shkollë ose në punëtori.
11. Të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organizatat rinore të shkollës dhe në organe të tjera dhe të marrë pjesë në gara diturie, sportive dhe kulturore për të cilat edhe mund të shpërblehet.
12. Të ankohet për vlerësimin e kontestueshëm dhe, në rast nevojë të veçantë, pas kërkesës me shkrim, t'i nënshtrohet vlerësimit para komisionit përkatës.
13. Sipas dispozitave në fuqi, të shpërblehet në bazë të suksesit të përgjithshëm dhe të talentit të treguar në lëmenj të veçantë.
14. T'u nënshtrohet provimeve të klasës.
15. Të mungojë 1 deri në 2 ditë mësimi, por vetëm me leje të kujdestarit të klasës, me kërkesën e prindit dhe për shkaqe të arsyeshme.
16. Sipas ligjit, të mungojë edhe me lejen e drejtorit.

III. OBLIGIMET E NXËNËSVE

Neni 6

Me qëllim të krijimit të atmosferës për punë dhe zhvillim normal të procesit edukativ - arsimor, përcaktohen këto obligime për nxënësin:

1. Të njohë e të respektojë Kodin e mirësjelljes dhe rregullat e shkollës.
2. Të respektojë orarin e mësimit të përcaktuar nga institucioni edukativ-arsimor,
3. Të respektojë arsimtarët, punëtorët e tjerë të shkollës, shokët dhe shoqet e klasës e të shkollës dhe të komunitetit.
4. Të mbajë qëndrim korrekt dhe të mos bëhet pengesë e zhvillimit normal të orës së mësimit.
5. Të shkojë në shkollë i pajisur me tekste, fletore e mjete të tjera të domosdoshme.
6. Të mbajë veshur uniformën e shkollës, si dhe veshjen dhe pajisjet përkatëse për lëndën e edukatës fizike dhe të praktikës profesionale.
7. Në rast sëmundjeje ose rastesh të veçanta familjare etj., mungesën ta arsyetojë me raport mjekësor ose të organit tjetër kompetent, nëpërmjet prindit ose kujdestarit të familjes.
8. Të njoftojë me kohë prindin ose kujdestarin e familjes së vet për shqetësimet, problemet dhe preokupimet dhe t'i dërgojë ftesën ose njoftimin e mësimdhënësit, të kujdestarit të klasës, të drejtorit të shkollës ose të organeve të tjera kompetente të shkollës.
9. Të mirëmbajë ambientin e brendshëm e të jashtëm shkollor.
10. Të kultivojë, të ruajë dhe të zhvillojë vlerat e mirëfillta edukative-arsimore, njerëzore, kombëtare dhe demokratike.
11. Të ruajë pasurinë e shkollës.
12. Të lajmërojë organet kompetente për çdo cenim të procesit edukativ-arsimor e të pasurisë së shkollës ose për çfarëdo keqpërdorimi tjetër nga radhët e nxënësve ose të personelit në dëm të interesit real të tij.
13. Të njohë e të zbatojë rregullat e punës në shkollë.
14. Të jetë gjithmonë i përgatitur për mësim dhe praktikë profesionale, të mirëmbajë mjetet e punës dhe të mos i keqpërdorë ato.
15. Pas mbarimit të orarit të mësimit, në hapësirën shkollore, të jetë i pranishëm vetëm në aktivitete të organizuara nga shkolla.

IV. VEPRIMET E NDALUARA

Neni 7

1. Nxënësit i ndalohet:
 - 1.1. Të prishë rendin dhe qetësinë në shkollë ose në orën mësimore.
 - 1.2. Të mbajë armë zjarri, armë të ftoftë ose gjësende të tjera të rrezikshme për jetën e nxënësve, të personelit dhe të tjerëve.
 - 1.3. Të ofendojë, të shpifë ose të shantazhojë shokët, shoqet, nxënësit e tjerë, arsimtarët dhe personelin teknik.
 - 1.4. Të hyjë me vonesë në orët e mësimit ose në praktikën profesionale.
 - 1.5. Të bartë ose të konsumojë duhan, pije alkoolike, prodhime narkotike ose të keqpërdorë barna ose lëndë të ngjashme.
 - 1.6. Të kopjojë në klasë ose të përçojë pa leje njohuritë gjatë kohës dhe në format e ndryshme të vlerësimit.
 - 1.7. Të bëjë zhurmë të pakontrolluar në mjediset shkollore.
 - 1.8. Të bëjë mungesa të paarsyeshme ose të qëndrojë pa nevojë në korridore ose në hapësira të tjera të shkollës.
 - 1.9. Të hyjë ose të qëndrojë në sallën e arsimtarëve ose në hapësira jo të destinuara për të pa praninë ose lejen e kujdestarit të klasës, arsimtarit kujdestar të ditës, anëtarit të personelit arsimor ose të drejtorit të shkollës.
 - 1.10. Të sjellë persona të huaj a të panjohur në shkollë pa paralajmërimin dhe pa lejen e drejtorisë së shkollës.
 - 1.11. Të përvetësojë pa leje gjësendet e huaja.
 - 1.12. Të falsifikojë të dhënat në dokumentet pedagogjike-shkollore (ditar, libër të amzës, dëftesë, diplomë etj.)
 - 1.13. Të përdorë telefonin celular, ose mjete të ngjashme, gjatë orës së mësimit dhe orës praktike ose të keqpërdorë në kohë dhe hapësirë mundësitë teknike të tyre.
 - 1.14. Të bartë dhe të përdorë ditarin e klasës.
 - 1.15. Të qëndrojë pa uniformën e miratuar në mjedisin shkollor ose të modifikojë formën e saj.
 - 1.16. Të vishet, të stoliset e të praktikojë makijazh në mënyrë ekstravagante e provokuese, ndesh me uniformën, me Kodin e mirësjelljes dhe dukjen normale.
 - 1.17. Të ikë individualisht ose të organizojë ikje kolektive nga procesi mësimor.
 - 1.18. Të dëmtojë inventarin dhe mjetet e punës.
 - 1.19. Të bartë uniformë fetare ose të praktikojë rituale fetare në hapësirën shkollore.
 - 1.20. Të mospërfillë ndalesat e tjera të ligjshme të caktuara nga organet arsimore komunale, shkollore etj.
 - 1.21. Të marrë pjesë në lojëra me karakter bixhozi, dhe të përvetësoj në mënyrë të palejuar sendet e huaja.

2. Veprimet e ndaluara nga pika 1 e këtij neni konsiderohen shkelje të rregullave të shkollës.

Shkeljet e rregullave të shkollës mund të jenë shkelje të lehta ose shkelje të rënda.

3. Shkelje të lehta të rregullave të shkollës konsiderohen veprimet e ndaluara nga pika 1.1, 1.4, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.13, 1.15, 1.16, dhe 1.20 të këtij neni.

4. Shkelje të rënda të rregullave të shkollës konsiderohen veprimet e ndaluara nga pika 1.2, 1.3, 1.5, 1.11, 1.12, 1.14, 1.17, 1.18 dhe 1.19 dhe 1.21 të këtij neni.

5. MASAT DISIPLINORE

Vijueshmëria në mësim dhe praktikë profesionale dhe masat disiplinore

Neni 8

1. Për mos vijueshmërinë e rregullt në orët e mësimit teorik dhe të praktikës profesionale nxënësit i shqiptohen këto masa disiplinore:

1.1. Nxënësit që mungon pa arsye 15 (pesëmbëdhjetë) orë mësimi, i thyhet nota e sjelljes në **e mirë** (3).

1.2. Nxënësit që mungon pa arsye 25 orë mësimi, i thyhet nota e sjelljes në **jo e mirë** (1) – para pezullim për një deri tre (1 – 3) muaj.

1.3. Nxënësi që mungon pa arsye 32 orë mësimi, pezullohet përkohësisht 1 – 3 (një deri në tre) muaj nga procesi mësimor dhe transferohet në shkollë tjetër më të afërt të komunës fqinje, në të njëjtin drejtim - profil, për vijimin e procesit mësimor.

1.4. Nxënësi që vazhdon të mungojë pa arsye edhe pas masës së pezullimit të përkohshëm 1 – 3 (një deri në tre) muaj nga procesi mësimor, pezullohet nga shkolla mbi 3 (tre) muaj - deri në fund të vitit mësimor.

2. Nxënësi i cili nuk vijon mësimin për më gjatë se 1/3 e kohës së paraparë për vitin shkollor, konsiderohet se ka hequr dorë vullnetarisht nga vijimi i mësimit dhe se kjo mungesë nuk është objekt i masave disiplinore.

Masat edukativo-disiplinore

Neni 9

Ndaj nxënësit mund të merren këto masa disiplinore:

1. Vërejtje me gojë (e shënuar),
2. Vërejtje me shkrim,
3. Pezullim i përkohshëm nga garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet,
4. Pezullim i përkohshëm nga shkolla për tri ditë,
5. Pezullim i përkohshëm nga shkolla 1 - 3 (një deri në tre) muaj,
6. Pezullim nga shkolla mbi 3 (tre) muaj.

Neni 10

Vërejtja me gojë

1. Masa Vërejtje me gojë (e shënuar në librin e klasës), i shqiptohet nxënësit i cili bënë; shkelje të lehta të rregullave të shkollës.
2. Masën Vërejtje me gojë e shqipton Kujdestari i klasës.

Neni 11

Vërejtja me shkrim

1. Masa Vërejtje me shkrim, i shqiptohet nxënësit i cili i përsërit shkeljet e rregullave të shkollës.
2. Masën Vërejtje me shkrim, e shqipton drejtori i shkollës me propozimin e kujdestarit të klasës.

Neni 12

Masa Pezullim i përkohshëm nga aktivitetet jashtëshkollore

1. Masa Pezullim i përkohshëm nga aktivitetet jashtëshkollore si garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet i shqiptohet nxënësit i cili me sjelljet e tij pengon aktivitetet jashtëshkollore.

2. Masën Pezullim i përkohshëm nga aktivitetet jashtëshkollë, e shqipton Kujdestari i klasës me propozimin e organizuesit të aktivitetit jashtëshkollë.

Neni 13

Masa Pezullim nga shkolla deri në tri ditë

1. Pezullim nga shkolla deri në 3 (tri) ditë, i shqiptohet nxënësit i cili nuk përmirësohet edhe pas shqiptimit të vërejtjeve paraprake.

2. Masën Pezullim nga shkolla deri në 3 (tri) ditë, e shqipton drejtori i shkollës me propozim të kujdestarit të klasës.

Neni 14

Masa Pezullim nga shkolla nga 1 – 3 (një deri në tre) muaj

1. Masa Pezullim nga shkolla për 1 (një) muaj, i shqiptohet nxënësit i cili nuk përmirësohet edhe pas shqiptimit të masave paraprake.

2. Masa Pezullim nga shkolla 1 (një) deri në 3 (tre) muaj, i shqiptohet nxënësit:

2.1. Që bënë sjellje të dhunshme apo agresive e cila nuk lejon vazhdimin e procesit edukativ - arsimor dhe aftësues të nxënësve të tjerë.

2.2. Që mungon 32 e më tepër orë mësimi pa arsye.

2.3. Që nuk zbaton vendimet e organeve të shkollës.

2.4. Që bënë shkelje të rënda të rregullave të shkollës, siç janë paraparë në dispozitën e nenit 7 pika 4 të kësaj rregulloreje.

2.5. Masën Pezullim nga shkolla 1 (një) deri në 3 (tre) muaj, e shqipton drejtori i shkollës me propozim të kujdestarit të klasës.

Neni 15

Masa Pezullim nga shkolla mbi tre muaj - deri në fund të vitit mësimor

1. Masa Pezullim nga shkolla mbi 3 (tre) muaj - deri në fund të vitit mësimor, i shqiptohet nxënësit i cili nuk përmirësohet edhe pas shqiptimit të masave paraprake sipas Nenit 14, me mundësi hyrjen në provime të klasës.

2. Masa Pezullim nga shkolla mbi 3 (tre) muaj - deri në fund të vitit mësimor, i shqiptohet nxënësit:

2.1. Që përsërit sjelljet e dhunshme apo agresive të cilat nuk lejojnë zhvillimin e rregullt të procesit edukativ - arsimor dhe aftësues.

2.2. Që përsërit 8 e më tepër mungesa pa arsye në orët mësimore.

2.3. Që vazhdon të mos zbatojë vendimet e organeve të shkollës.

2.4. Që përsërit shkeljet e rënda të rregullave të shkollës, siç janë paraparë në dispozitën e nenit 7 pika 4 të kësaj rregulloreje.

2.5. Provimet e klasës organizohen vetëm me test gjithëpërfshirës lëndor të para poentuar dhe në prani të komisionit përkatës.

2.6. Masën nën pikën 1 të nenit 15 e shqipton drejtori i shkollës me propozim të kujdestarit të klasës, pas njoftimit të Këshillit të Shkollës.

Neni 16

1. Masa e caktuar disiplinore nxënësit mund t'i shqiptohet vetëm pas zbatimit të procedurës së vërtetimit të fakteve dhe rrethanave të cilat dëshmojnë për shkeljen e kryer.
2. Masa disiplinore për shkelje të rënda të rregullave të shkollës nuk mund t'i shqiptohet nxënësit nëse mungon deklarata me shkrim e tij, përveç në rastet kur nxënësi në asnjë mënyrë nuk i përgjigjet kërkesës për deklaratë me shkrim.

VI. PROCEDURA E INICIMIT, ZHVILLIMIT, VËRTETIMIT TË PËRGJEGJËSISË DHE SHQIPTIMIT TË MASAVE DISIPLINORE

Neni 17

1. Të gjithë nxënësit dhe personeli arsimor e teknik i shkollës kanë të drejtë dhe detyrë që posa të jenë në dijeni për shkeljen e të drejtave dhe dëmet e shkaktuara në hapësirën shkollore të lajmërojnë kujdestarin e klasës, kujdestarin e ditës, drejtorin e shkollës.

2. Inicimin e procedurës disiplinore (edhe me shkrim) mund ta bëjë kujdestari i klasës, kujdestari i ditës, arsimtari i lëndës, këshilli i klasës, këshilli i arsimtarëve dhe drejtori i shkollës.

3. Organi kompetent për shqyrtimin e masës disiplinore ka për detyrë që kërkesën me shkrim për inicimin e procedurës ta shqyrtojë dhe në afat 3-ditësh të marrë vendim përkritazi me çështjen e parashtruar.

Neni 18

1. Zhvillimin e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë e bëjnë organet kompetente për shqiptimin e masave disiplinore në pajtim me këtë rregullore.

2. Për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës disiplinore dhe të masave disiplinore ndaj nxënësit, organet kompetente janë të obliguara ta njoftojnë nxënësin dhe prindin e tij.

3. Prindi njoftohet me shkrim përmes nxënësit, me telefon ose në forma të tjera të komunikimit.

4. Nëse vërtetohet se nxënësi nuk e njofton prindin ose prindi nuk i përgjigjet rastit, kujdestari i klasës këtë duhet që në praninë e nxënësve të klasës ta shënojë në ditar në faqen përkatëse.

5. Masat e shqiptuara sipas neneve 12, 13, 14 dhe 15 të kësaj Rregulloreje publikohen përmes fletores dhe tabelës së shpalljeve.

Neni 19

1. Për vërtetimin e përgjegjësisë duhet të zhvillohet procedura disiplinore, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme si dhe provat. Për vërtetimin e përgjegjësisë duhet të merren për bazë këto prova:

- 1.1. Dokumentet e evidencës pedagogjike - shkollore: ditari, libri amë etj.;
- 1.2. Dëshmitarët dhe deklaratat e tyre;
- 1.3. Procedurat tjera që ofrojnë fakte për këtë çështje.

Neni 20

Para shqiptimit të masës disiplinore, nxënësi do të japë mendimin e vet gojarisht, në procesverbal ose me shkrim. Nxënësi thirret të japë mendimin e vet me gojë, në procesverbal ose me shkrim menjëherë pas paraqitjes së kërkesës për iniciimin e procedurës nga organi kompetent.

Neni 21

1. Kujdestari i klasës është i obliguar që masat e shqiptuara t'i evidentojë në ditar në faqet përkatëse, si p.sh. evidencat karakteristike të punës me paralele dhe në faqen: shënime të tjera.

2. Kujdestari i klasës është i obliguar që të evidentojë në faqen përkatëse në ditar edhe konstatimin për braktisjen e shkollimit në kuptim të nenit 8 pika 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 22

Drejtori i shkollës obligohet që ta njoftoj Drejtorinë Komunale për Arsim (DKA) për shqiptimin e masës Pezullim nga shkolla 1 - 3 (një deri në tre) muaj dhe t'i kërkojë sigurimin e mësimit alternativ, si dhe për masën Pezullim nga shkolla mbi 3 (tre) muaj - deri në fund të vitit mësues, me mundësi hyrjen në provime të klasës.

VII. PËRGJEGJËSIA PËR SHKAKTIMIN E DËMIT MATERIAL

Neni 23

Me qëllim të mbajtjes së rregullit, rendit, pastërtisë dhe higjienës në institucionet edukative – arsimore, janë paraparë edhe ndalesat dhe gjobat. Për dëmet të cilat i shkaktojnë nxënësit do të përgjigjen vet ata ose prindërit e tyre. Shqiptimi i masave bëhet vetëm në rastet kur organi kompetent konstaton se veprimet e ndaluara i kanë bërë vet nxënësit më dashje.

Neni 24

1. Veprime të ndaluara dhe që sanksionohen me gjobë:

1.1. Shkarravitja, gërvishtja, vizatimi, dëmtimi etj. i mureve, i inventarit e i pasurisë tjetër shkollore.

1.2. Prishja e rendit ekologjik, hedhja e mbeturinave jashtë shportave nëpër klasa e në mjediset e jashtme dhe shkelja e sipërfaqeve të gjelbëruara në oborrin e shkollës.

1.3. Futja në shkollë e gjësendeve dhe mjeteve piroteknike të rrezikshme për shkaktim zjarri apo eksplozim.

2. Gjobat për veprimet e ndaluara që sanksionohen do të jenë në përputhje me vlerën e dëmit.

2.1. Për shqiptimin e kësaj mase disiplinore kompetent është Komisioni prej tre anëtarëve, të cilin e formon drejtori i shkollës.

2.2. Komisioni është i obliguar të caktojë lartësinë e dëmit të shkaktuar dhe të lëshojë vendim me shkrim për nxënësin e ndëshkuar, ndërsa për zbatimin e këtyre masave kompetent është drejtori i shkollës.

VIII. E DREJTA PËR ANKESË

Neni 25

1. Shkalla e Parë-Këshilli i Shkollës.
2. Shkalla e Dytë-Drejtoria Komunale e Arsimit.
3. Pala e pakënaqur me masat e shqiptuara ka të drejtë ankese në afat brenda 3 ditësh pas marrjes së vendimit.
4. Organi kompetent ankesën e shqyrton në afat brenda 3 ditësh nga dita e pranimin të ankesës.
5. Ankesa kundër masës së shqiptuar disiplinore i bëhet organit kompetent të shkallës së dytë (DKA).
6. Ankesa e pezullon zbatimin e vendimit deri në vendimin e shkallës së dytë, me përjashtim të rasteve kur rrezikohet siguria e nxënësve dhe personelit ose dinjiteti moral.
7. Vendimi i DKA është përfundimtar.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 26

Në rastet kur kjo Rregullore bie në kundërshtim me Ligjet e Republikës së Kosovës, do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 27

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja për të Drejtat, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Nxënësve të Shkollave të Mesme të Larta të Komunës së Kaçanikut 01 Nr. 04-16-13918/2011 të 31.10.2011.

Neni 28

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Neni 29

Përgjegjës për zbatimin e Rregullores janë shkollat e mesme të larta të Komunës së Kaçanikut dhe Drejtoria Komunale e Arsimit e Komunës së Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

